



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 23.19.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË AUTORITETIT
RREGULLATIV TË HEKURUDHAVE PËR VITIN E PËRFUNDUAR
MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, maj 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i ekipit Edona Abazi-Demolli, dhe Anëtares së ekipit Lindita Ajeti, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Faruk Rrahmani.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	14
5 Qeverisja e mirë.....	15
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	17
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	20
Shtojca III: Letërkonfirmimi	23

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 16/04/2018.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave.

Zyra Kombëtare e Auditimit e vlerëson bashkëpunimin e treguar nga menaxhmenti i lartë dhe stafi i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e Menaxhmentit

Menaxhmenti i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (ARH). Ne kemi analizuar veprimtarinë e ARH-së, se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklaratat e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin, Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr. 04/L-194 dhe Ligjin, Nr. 05/L-063), dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për

kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin, Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr. 04/L-194 dhe Ligjin, Nr. 05/L-063).

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të ARH-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

ARH kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMPPP-së nr. 03/L-048 (i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin, Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr. 04/L-194 dhe Ligjin, Nr. 05/L-063);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve; dhe
- Planin dhe raportin përfundimtar të Prokurimit.

Në kontest të Pasqyrave Financiare kemi dy çështje për t'i ngritur:

- *Te neni 14 Raporti i ekzekutimit të buxhetit* – Te kolona e realizimit ekziston një diferencë prej 308€ në mes të dhënave të SIMFK-së dhe PFV-ve të organizatës; dhe
- *Te neni 19 - Raporti për pasuritë jofinanciare, stoqet* - vërehet se stoqet ishin të mbivlerësuara për 5,061€. Vlera e prezantuar e stoqeve në PFV ishte 7,639€ e ku në regjistrë janë përfshirë edhe pasuritë të cilat janë të evidentuara në regjistrin e pasurive nën 1,000€. Vlera reale e stoqeve sipas regjistrave të brendshme ishte 2,578€.

Të gjitha kërkesat tjera për raportim si në kontekst të PVF-ve ashtu edhe të raportimit të jashtëm ishin përmbushur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjen e ngritur më lartë ne japim rekomandimin si në vijim:

Rekomandimi 1 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë prezantimin e drejtë dhe të plotë të informatave në pasqyra financiare përfshirë pasuritë jofinanciare (stoqet). Gjithashtu, duhet vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj pasqyrave financiare vjetore janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi shpenzimet dhe të hyrat në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive.

Megjithatë mangësi ishin identifikuar në menaxhimin e pozitive udhëheqëse me ushtrues detyre përtej afateve dhe në menaxhimin e pasurive, me theks të veçantë te evidencat e stokeve dhe zhvlerësimi i pasurive nën 1,000€. Në këto fusha kërkohet përmirësim i mëtijshëm me qëllim të një menaxhimi më efektiv.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	303,823	313,823	290,992	201,251	237,903
Granti i Qeverisë -Buxheti	303,823	313,823	290,992	201,251	237,903

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 10,000€, në kategorinë e pagave dhe mëditjeve. Kjo rritje ishte bërë me rishikim të buxhetit, si rezultat i kërkesës e ARH-së për të mbuluar shpenzimet e pagave për Bordin, i cili ishte formuar në fund të vitit 2016.

Në vitin 2017, ARH ka shpenzuar 93% të buxhetit final ose 290,992€, që tregon se realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	303,823	313,823	290,992	201,251	237,903
Pagat dhe Mëditjet	177,744	187,744	180,726	124,918	123,270
Mallrat dhe Shërbimet	114,179	119,679	103,963	70,337	108,659
Shërbimet komunale	11,900	6,400	6,302	5,996	5,974

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final në krahasim me atë fillestar për paga dhe mëditje, ishte rritur për 10,000€, si dhe ishte realizuar me 96%. Kjo rritje ka ndodhur për arsye të mbulimit të shpenzimeve të pagave për Bordin, i cili ishte emëruar në fund të vitit 2016; dhe
- Rritja e buxhetit final për mallra dhe shërbime me 5,500 € është si rezultat i transferit të mjeteve nga shpenzimet komunale në këtë kategori. Realizimi për këtë fushë është 87%, kurse buxheti për shërbime komunale ishte realizuar me 98%.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Të hyrat

ARH për herë të parë ka filluar me gjenerim të të hyrave në vitin 2017, ku janë inkasuar 2,450€ Këto të hyra kanë të bëjnë me taksat dhe gjobat, të cilat lidhen me rregullimin dhe sigurinë e transportit hekurudhor.

Te hyrat e realizuara ishin nga: taksa për aplikim dhe regjistrim të mjeteve lëvizëse, si dhe taksa për aplikim dhe licencim të makinistëve. Të hyrat e inkasuara transferohen në buxhetin e konsoliduar. Ne kemi testuar dhe verifikuar se këto të hyra janë inkasuar dhe raportuar në pajtueshmëri me ligjet përkatëse.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike dhe MF. Sipas shënimeve të SIMFK-së, buxheti për kategorinë e pagave dhe shtesave ishte 187,744€, ndërsa realizimi i shpenzimeve ishte 180,726€.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Menaxhimi i personelit

Numri i planifikuar i stafit ishte 24, kurse numri aktual në dhjetor të vitit 2017 ishte 20, përfshirë 15 punonjës në njësinë operative dhe pesë anëtarë të Bordit përfshirë kryetarin, të cilët janë emëruar nga Kuvendi i Kosovës.

Çështja 2 – Mbulimi i pozitave udhëheqëse me ushtrues detyre

E gjetura Ligji i Shërbimit Civil SHC-03/L149, neni 30 përcakton se një pozitë nuk mund të mbahet me ushtrues të detyrës (UD) për më shumë se tre muaj. Dy pozita menaxhuese kanë qenë të mbuluara me UD për më gjatë se tre muaj. Prej tyre njëra pozitë nga nëntori 2016 dhe tjetra nga marsi 2017.

Vlen të theksohet se pozita e Drejtorit të Administratës ishte zgjedhur në prill 2018, kurse ajo e Drejtorit të Përgjithshëm² edhe pse ishte zgjedhur në tetor 2017 nga ana e Bordit ajo më pas ishte anuluar pas ankesave³ dhe vazhdon të ushtrohet me UD.

Rreziku Menaxhimi me UD përtej afateve ligjore rritë rrezikun që zyrtarët e emëruar mund të hasin në pengesa në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive në raport me kërkesat. Kjo ndikon që përgjegjësia dhe llogaridhënia në punë të mos përfillet dhe e gjithë kjo reflektohet edhe në menaxhimin jo efektiv.

Rekomandimi 2 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet që të bëhet një zgjidhje e qëndrueshme dhe në pajtim me kërkesat ligjore. Nga kjo, të sigurohet se pozitat udhëheqëse nuk ushtrohen me UD përtej afateve, sepse kjo ka ndikim vendimtar për funksionimin e kontroleve dhe arritjen e objektivave.

² Procedurat e rekrutimit të Drejtorit të Përgjithshëm i udhëheq MAP-i kurse vendimin e merr Bordi i ARH-së.

³ Për arsye të lëshimeve procedurale nga ana e MAP-it, në janar 2018 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës e kishte anuluar këtë vendim të Bordit.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime, duke përfshirë shërbimet komunale në vitin 2017 ishte 126,079€. Prej tyre ishin shpenzuar 110,266€. Ne kemi rishikuar proceset e blerjes së mallrave apo shërbimeve të pranuar. Nga këto testime, vlerësojmë se ARH kishte arritur të zbatojë kërkesat ligjore, qofshin financiare apo ato të prokurimit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.6 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera neto e pasurive kapitale e shpalosur në PFV ishte 12,058€. Kurse, pasuri jo kapitale ishin 8,550€, dhe vlera e stoqeve ishte 7,639€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencave është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullës së MF-Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, procesin e inventarizimit, zhvlerësimin dhe ekzistencën fizike të pasurive.

Çështja 3 – Mos zhvlerësimi i pasurive nga sistemi e-pasuria

E gjetura Edhe pse menaxhmenti ka bërë kërkesë në MAP për funksionimin e duhur të sistemit e-pasuria ne kemi vërejtur se vlera neto e pasurisë nën 1,000€ nuk ishte e saktë si rezultat që sistemi nuk ishte duke e kalkuluar zhvlerësimin. Si pasojë informatat e pasurive nën 1,000€ në PFV janë prezantuar në vlerën bruto përfshirë edhe vlerën e zhvlerësuar të tyre.

Rreziku Funksionimi me mangësi i sistemit e-pasuria dhe mos zhvlerësimi i pasurisë sipas normave të rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive ndikon në mbivlerësim të pasurive dhe prezantim jo të saktë të tyre në PFV.

Rekomandimi 3 Kryesuesi i Bordit duhet të vazhdojë tutje bashkëpunimin dhe përpjekjet me MAP-in për siguruar që zhvlerësimi i pasurive bëhet në pajtim me rregulloren në fuqi, si dhe të sigurohet raportim i saktë i vlerës së tyre në PFV.

3.7 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 1,359€, prej tyre 810€ ishin obligime të papaguara nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, ndërsa 549€ për shërbime komunale. Të gjitha këto janë fatura të pranuar gjatë muajit dhjetor, për shërbimet e

pranuara për vitin 2017. ARH kishte raportuar në baza të rregullta mujore për obligimet e papaguara.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e ARH-së për vitin 2016, ka rezultuar me shtatë rekomandime kryesore. Menaxhmenti ka ndërmarrë veprime për t'i adresuar çështjet e ngritura, megjithëse ende mbetet sfidë zbatimi i plotë i tyre.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, tri rekomandime janë zbatuar, dy janë në proces të zbatimit, ndërsa dy tjera nuk janë zbatuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur dy rekomandime prej të cilave, një është në proces të zbatimit kurse rekomandimi lidhur me regjistrin e rreziqeve mbetet i pazbatuar edhe këtë vit.

Një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato shihni Shtojcën II.

Çështja 4 - Zbatimi i rekomandimeve nga dy vitet paraprake

E gjetura	Edhe përkundër progresit dhe angazhimit të menaxhmentit për të zbatuar rekomandimet e dhëna, një numër i tyre kanë mbetur në proces të zbatimit ose të pazbatuara. Rekomandimet e pazbatuara plotësisht kanë të bëjnë me menaxhimin e pasurive (stoqet dhe zhvlerësimi i pasurive në e-pasuria), mungesën e planit strategjik dhe regjistrin të rreziqeve.
Rreziku	Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë me mos efikasitet të vazhdueshëm të kontrolleve, dhe vështirësi në përmbushjen e objektivave.
Rekomandimi 4	Kryesuesi i Bordit duhet të rishikoj dhe analizoj shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor me stafin përgjegjës për zbatimin e tyre, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Progresi në zbatimin e rekomandimeve duhet të monitorohet në vazhdimësi.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i një pjese të madhe të rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjerë janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

ARH në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Disa aspekte të qeverisjes kërkojnë të përmirësohen, veçanërisht në lidhje me hartimin e planit strategjik dhe regjistrin të rreziqeve. ARH ka bërë progres të lehtë në zbatimin e rekomandimeve nga kjo fushë. Megjithatë regjistri i e-pasurisë dhe ai i stoqeve kërkojnë përmirësim të mëtutjeshëm.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Sipas UA Nr. 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB), ARH nuk i plotëson kriteret për themelimin e kësaj njësie.

Rekomandime

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, megjithatë hartimi i regjistrit të rreziqeve dhe e planit strategjik mbetet ende çështje e cila duhet përmirësuar tutje.

Çështja 5 - Mungesa e regjistrit të rreziqeve dhe planit strategjik

E gjetura ARH nuk e kishte hartuar regjistrin e rreziqeve, siç kërkohet me rregullat e MFK-së. Si pasojë, ARH kishte vepruar pa analizuar dhe identifikuar rreziqet që mund të ballafaqohet organizata gjatë vitit.

Po ashtu, plani strategjik ende nuk ishte hartuar deri në fund të auditimit tonë. Procedurat iniciuese kishin filluar në vitin 2018, po ende nuk kanë filluar me formimin e grupeve punuese.

Rreziku Mungesa e regjistrit të rreziqeve dhe e planit strategjik mund të pamundësojë reagimin me kohë ndaj rreziqeve me të cilat ballafaqohet organizata, qofshin ato nga mjedisi i brendshëm apo i jashtëm. Kjo për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.

Rekomandimi 5 Kryetari i Bordit duhet të siguroj se po ndërmerren veprime konkrete në hartimin e planit strategjik dhe regjistrit të rrezikut duke siguruar më pastaj monitorim efektiv për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar.			Nuk janë marrë masa.
3.5 Menaxhimi i pasurisë	Ndonëse janë marrë disa veprime nga Drejtori i Përgjithshëm, megjithatë me qëllim të evitimit të çështjeve të theksuara, duhet që të njëjtat të adresohen tek bordi i ri i ARH-së. Kjo nënkupton edhe një monitorim të mirëfilltë të aseteve dhe mjeteve themelore, në mënyrë që prezantimi i pasurisë të jetë i drejte si dhe të parandalohen keq përdorimet eventuale.		Janë marrë disa veprime por kërkojnë përmirësime të mëtejshme.	
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes dhe që janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shpalosjet e kërkuara dhe pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet në MF, përveç kur ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.		Në proces të zbatimit, pjesa e regjistrimit të stoqeve mbetet e pa korrigjuar (kjo diferencë nuk është materiale për vitin 2017).	

2.2 Pyetësi i vetëvlerësimit	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se është analizuar plotësimi i pyetësorit të vet-vlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë proaktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e pyetësorit si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës. Rëndësi e veçant duhet t'i kushtohet zhvillimit të procesit të menaxhimit të rrezikut.	Po		
2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes	Kryesuesi i Bordit duhet të ndërmarrë veprime konkrete drejt procesit të hartimit të planit strategjik, si dhe të hartojë planin e veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes së progresit dhe rezultateve.			Në 2018 janë formuar grupet për plan strategjik.
2.3.2 Organizimi i brendshëm	Kryesuesi i Bordit duhet të iniciojë rishikimin e strukturës aktuale të ARH-së dhe një organogram ta propozojë për miratim nga ana e Bordit jo më larg se 1 tetor 2017. Subjekt i rishikimit të Bordit duhet të jenë të gjitha operacionet e ARH-së që kërkohet të rishikohen nga Bordi e që janë zhvilluar gjatë periudhës pas skadimit të mandatit të bordit paraprak për të siguruar që janë në pajtueshmëri me rregulloret dhe kërkesat ligjore.	Po		
3.1.1 Pagat dhe Mëditjet	Kryesuesi i Bordit duhet t'i forcojë kontrollet në menaxhimin e personelit për të siguruar harmonizimin e të dhënave dhe plotësimin e dosjeve të personelit dhe azhurnimin sistematik të tyre si dhe aplikimin e plotë të SIMBNj-së. Sfidat në përdorimin e SIMBNj-së duhet të adresohen në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike përfshirë edhe trajnimet e nevojshme për stafin.		Në proces të zbatimit, SIMBNj ka filluar funksionimin, dhe stafi ishte në proces të futjes së të dhënave.	

3.1.2 Mallrat dhe Shërbimet	Kryesuesi i Bordit duhet t'i forcojë kontrollet buxhetore dhe të prokurimit si dhe të sigurojë që mjetet zotohen para nënshkrimit të kontratës publike. Urdhërblerja duhet të nënshkruhet pas nënshkrimit të kontratës dhe para pranimit të mallrave dhe/apo shërbimeve.	Po		
3.2 Pasuritë	Kryesuesi i Bordit duhet të iniciojë dhe kërkojë një rishikim të sistemit e-pasuria nga Ministria e Administratës Publike për të konfirmuar që ky sistem përmbush kushtet për të siguruar se regjistrimi dhe menaxhimi i pasurisë bëhet në përputhje me kërkesat e rregullores nr. 02/2013. Po ashtu duhet të sigurohen trajnimet e duhura për stafin e ARH-së përgjegjës për zbatimin e këtij sistemi.			Nuk janë marrë masa.

Shtojca III: Letërkonfirmimi

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Shkelzen Qorri, U.d Drejtor i Përgjithshëm

Data: 25.Maj.2018, Pfishinë,

